

VENDIM
Nr. 817, datë 26.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 27, DATË 19.1.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË
DHËNIES SË KONCESIONEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i tretë dhe të tjerët në vijim të pikës 2, të kreut IV, “Dokumentet standarde të procedurës konkurruese”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Për koncesionet e hidrocentraleve deri në 15 MW, në kontratë përfshihen kushtet e përgjithshme apo të veçanta për shitblerjen e energjisë. Kur e kërkon koncesionari, operatori i energjisë elektrike që është ngarkuar me këtë detyrim detyrohet ta blejë energjinë elektrike të prodhuar nga këto hidrocentrale nëpërmjet një kontrate afatgjatë. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet e lidhura në sistemin e shpërndarjes dhe çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet e lidhura në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike do të llogaritet çdo vit nga Enti Rregullator i Energjisë e do të shpallet prej tij në fillim të çdo viti, në bazë të formulës së mëposhtme:

Çmimi shitjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent /kWh X koeficientin 1.1 (kur është i aplikueshëm) X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

- Me çmim mesatar të vitit përkatës të bursës hungareze HUPX të energjisë elektrike kuptohet çmimi mesatar vjetor, i ponderuar për produktin në bandë për vitin, për të cilin ERE do të miratojë tarifën përkatëse, siç publikohet nga bursa e Hungarisë HUPX në faqen e internetit: www.hupx.hu, më 1 dhjetor të vitit kur ERE merr vendimin për miratimin e çmimit.

- Koeficienti 1.1 llogaritet dhe përfshihet vetëm për përcaktimin e çmimit të energjisë së prodhuar nga hidrocentralet e lidhura në sistemin e shpërndarjes dhe merr në konsideratë reduktimin e humbjeve teknike në këtë rrjet si pasojë e furnizimit të energjisë elektrike në pikat e lidhjes së këtyre hidrocentraleve në rrjetin energjetik të tensionit të mesëm dhe/ose të ulët.

- Me normë mesatare të shkëmbimit euro/lekë të vitit të fundit kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit nga euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin në të cilin ERE merr vendimin.”

b) Paragrafët e katërt, të pestë dhe të gjashtë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut V, “Udhëzime për mënyrën e zbatimit të procedurave konkurruese”, shfuqizohen.

2. Vendimi nr. 907, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për nxitjen e investimeve private në sektorin e energjisë e prodhimit të energjisë elektrike dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve””, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama